



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.125, datë 24.12.2020

PËR  
MIRATIMIN E NGRITJES SË KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE  
SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre” i ndryshuar, Udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko-Kulturor”, dhe sipas Relacionit të Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :

1. Miratimin e ngritjes të Këshillit Artistiko-Kulturor pranë Bashkisë Durrës me mandat dy vjeçar, me përbërjen si më poshtë:

|           |         |           |                |
|-----------|---------|-----------|----------------|
| • Adrian  | Gurra   | Drejtor   | Dr AKRSKF      |
| • Aishe   | Stari   | Aktore    | Arti Skenik    |
| • Fatos   | Kullaj  | Publicist | Studimore      |
| • Shpresa | Beqiraj | Piktore   | Arti Figurativ |
| • Eduart  | Shehi   | Arkeolog  | Studimore      |
| • Shaban  | Sinani  | Studiues  | Studimore      |
| • Ermir   | Dizdari | Dirigjent | Muzikë         |

- Dritan Babamusta Sportist Sport
- Indrit Çobani Aktor Arti Skenik
- Aldo Aliaj Koreograf Arti Skenik
- Hasan Ulqini Shkrimtar Studimore

2. Miratimin e pagesës për çdo anëtar të Këshillit Artistiko-Kulturor në shumën prej 3500 lekë (tremijë e pesëqind lekë) për çdo mbledhje.
3. Ky këshill do të ketë karakter këshillimor me mandat dy-vjeçar dhe do të mblidhet jo më shumë se gjashtë herë në vit.
4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Artistiko-Kulturor do të përballohet nga shpenzimet operative (Art.602) të Bashkisë Durrës.
5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 548, datë 25.10.2018 “Për miratimin e ngritjes së Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, shfuqizohet.
6. Ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

### KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 24.12.2020**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 1103 prot.



Durrës, më 30.12 .2020

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.125 datë 24.12.2020

“Për miratimin e ngritjes së këshillit artistiko-kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

